

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË RUBIK

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Rubik me objekt: “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik financiar” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 65, datë 16.5.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 142/6, datë 16.5.2012, dërguar z. **Gjok VUKA**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Menaxheri i njësisë së qeverisjes vendore për inventarizimet dhe menaxhimin e aktiveve duhet ta dokumentojë këtë proces duke nxjerrë: urdhër për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe asgjësimit, lista e aktiveve të identifikura për vlerësim, procesverbali i asgjësimit, relacioni, procesverbali i asgjësimit, relacion për objektet e asgjësuar, fletëdalja, sipas “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, rregullorja për menaxhimin e aktiveve.

Vazhdimisht

2. Anëtarët e njësisë së prokurimit, që kanë marrë pjesë në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk kanë të drejtë të votojnë por duhet të jenë të pranishëm gjatë fazës së hapjes dhe të vlerësimit, sipas VKM nr. 1, datë. 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa a.

Vazhdimisht

3. Specialistët në zbatim, drejtuesit teknikë dhe administratorët e operatorëve konkurrues duhet të jenë të kontraktuar, të jenë në listë pagesat dhe t`i referohen pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të tatimit mbi të ardhurat personale për personelin drejtues e tekniko-ekonomik, sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike dhe të kërkesave të vendit të punës për kualifikim, sipas klasifikimit në vendin ku ushtrohet veprimtaria e biznesit bazuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 45, pika 2/d, VKM nr. 285, datë 4.5.2007, “Për caktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore” dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007, pika 4/v.

Vazhdimisht

4. Investitori mund të zgjasë afatin e punimeve me kërkesën zyrtare të mbikëqyrësit sipas kërkesës së sipërmarrësit të punimeve kur nuk janë në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe ndryshimet e miratuara ti dërgohen zyrtarisht sipërmarrësit të punimeve sipas UKM nr. 2, datë 13.5.2005 kreu I, pika, 7.2, 7.3 dhe kreu II, pika 10.

Vazhdimisht

5. Autoriteti kontraktor duhet të fillojë procedurën për prokurimin e fondeve publike duke pasur në dispozicion fondet në përputhje me ligjin nr. 9463, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 12/1 dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu I, pika 1.

Vazhdimisht

6. Autoriteti kontraktor për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës duhet të mbajë procesverbal i cili duhet të nënshkruhet nga të gjithë zyrtarët e përfshirë në proces dhe dokumentacion të plotë, në mënyrë të tillë që të lejojë kontrollin e zbatimit të ligjit sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VI, pika 1/c.

Vazhdimisht

7. Autoriteti kontraktor, njësia e prokurimit, përpara lidhjes së kontratës i kërkon operatori teknik të shpallur fitues të paraqesë dokumentacionin administrativo ligjor në formë të shkruar (original ose fotokopje e noterizuar) të paraqitur në tender, sipas Udhëzimit të APP.

Vazhdimisht

8. Autoriteti kontraktor, Komisioni i vlerësimit të ofertave, për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës duhet ti shqyrtojë propozimet e operatorëve ekonomike dhe të shpallë fituesin, në bazë të specifikimeve dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit ku çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbalin e prokurimit i cili duhet të nënshkruhet nga të gjithë zyrtarët e përfshirë në proces dhe dokumentacion të plotë në zbatimin të ligjit nr. 9463, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 12/2, dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu V, VI, pika 1/b, 4/i.

Vazhdimisht

9. Autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe për hyrjet që bëhen, duhet të kontrollojë në se fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës si: procesverbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit të fotokopjuar, fletë hyrje origjinale dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit sipas kërkesave të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b dhe UMF nr. 54, datë 15.7.2010 “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Vazhdimisht

10. Autoriteti kontraktor duhet të hartojë regjistrin e realizimit të prokurimeve publike duke i dërguar APP-së një raport të prokurimeve të realizuara, të kryera prej tyre gjatë vitit ushtrimor brenda datës 11 janar në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu I, pika 3/d.

Vazhdimisht

11. Bashkia Rubik duhet të ushtrojë funksionet e saj duke miratuar paraprakisht në Këshillin Bashkiak strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës, të njëjste në varësi të bashkisë, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikimin, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve dhe të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32.

Menjëherë

12. Në blerjet me vlera të vogla në procesverbalin e mbajtur nga komisioni i blerjeve duhen pasqyruar detyrimisht ofertat nga të paktën tre operatorë sipas formularit nr. 4, jo vetëm oferta me të cilën është bërë blerja, sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu 6, pika 2/c dhe Udhëzimit të APP për blerjet me vlera të vogla.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej 1,495,368 lekë, nga personat e subjektet si më poshtë:

a. Sa përfituar shumën 180,704 lekë me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 2, datë 5.02.2010 në kundërshtim me VKM nr. 313, datë 01.7.2002 “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës”, ku numri maksimal dhe struktura e punonjësve të policisë për Bashkinë Rubik është 3, nga të cilët 1 inspektor dhe 2 policë.

1. ■■■ në shumën 149,184 lekë përfituar tepër si kryeinspektor kur struktura e punonjësve të policisë për Bashkinë Rubik është një inspektor.

2. ■■■ 7,880 lekë, ■■■■ 7,880 lekë, ■■■ 7,880 lekë dhe ■■■ 7,880 lekë përfituar tepër si inspektor kur struktura e punonjësve të policisë për Bashkinë Rubik është dy policë.

Menjëherë

b. ■ me detyrë roje i konviktit i cili ka përfituar ½ pagës shtesë në shumën 145,772 lekë mbi pagën e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 2, datë 5.02.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Bashkisë Rubik, si dhe pagat e tyre” kur ndërkohë i janë paguar 40 orë shtesë për çdo muaj për vitin 2010 dhe për periudhën janar–gusht 2011.

Menjëherë

c. Vlera prej 411,434 lekë të shkaktuara nga mos arkëtimi i 1% të vlerës së investimit sipas preventivit të objektit e përcaktuar në nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” sipas subjekteve:

- Investitori ■ detyrimi në shumën 206,950 lekë, për objektin “Rikonstruksion dhe ngritje kati” në qytetin Rubik.

- Investitori ■ detyrimi në shumën 140,077 lekë, për objektin “Rikonstruksion i pikës së karburantit” në qytetin Rubik.

- Investitori ■ detyrimi në shumën 13,213 lekë, për objektin “Ndërtim verande” në qytetin Rubik.

- Investitori ■ detyrimi në shumën 51,176 lekë, për objektin “Rikonstruksion dhe ngritje kati banese” në qytetin Rubik.

Menjëherë

d. Vlera prej 757,458 lekë marrë tepër mbi pagën e miratuar nga Këshilli Bashkiak për vitin 2010-2011 për nëntë punëtorët e konviktit e çerdhes së fëmijëve në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 717, datë 23.6.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, lidhja nr. II, si: ■ 80,390 lekë, ■ 66,775 lekë, ■ 87,962 lekë, ■ 73,803 lekë, ■ 124,307 lekë, ■ 95,702 lekë, ■ 83,445 lekë, ■ 56,648 lekë, ■ 88,453 lekë.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 7, pika 2, 3/a, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që:

Në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik të vendosë gjoba në masën 50,000 lekë për personat e mëposhtëm :

1. ■ titullari i Autoritetit Kontraktor:

Për shkeljet e konstatuara në prokurimet publike të kryera nga Bashkia Rubik për vitet 2010, 2011, si më poshtë:

- Për tenderin “Sistemim asfaltim rruga Fang faza e parë Rrubik”, në datën 15.8.2011 është hartuar shtesë kontrate firmosur nga sipërmarrësi i punimeve ■ dhe kryetari i bashkisë ■ për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve deri në datën 14.9.2011 ku thuhet se shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve bëhet në bazë të kërkesës së sipërmarrësit të punimeve “Ekskluziv” sh.p.k. dhe aprovimit të dhënë nga mbikëqyrësi i punimeve kur në fakt ata kanë njoftuar përfundimin e punimeve dhe marrjen në dorëzim të tyre në datën 14.8.2011 duke marrë për bazë afatin prej 90 ditë dhe jo atë prej 60 ditësh.

-Shtesa e kontratës është hartuar pa asnjë nga shkaqet e përmendur në kontratën bazë neni 25, “Rastet e kompensuar”, shtyrja e punimeve ndodh kur:

a. kur mbikëqyrësi i punimeve urdhëron shtyrjen ose nuk jep skicat, specifikimet teknike për kryerjen e punimeve.

b. për zbulimin e punimeve të fshehta.

c. vonesat në lirimimin e sheshit të ndërtimit.

d. vonesat në lëshimin e certifikatës së marrjes në dorëzim.

Arsyet e shtyrjes janë: “Mos financimi i plotë nga ana e buxhetit të shtetit për investimin e çelur dhe për shkak të vazhdimisht të punimeve të fazës së dytë të këtij objekti” dhe nuk ka asnjë kërkesë ku të kërkohet shtyrja e afateve nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve sipas UKM nr. 2, datë 30.5.2005, “Mbikëqyrësi njofton vazhdimisht sipërmarrësin për porosinë, urdhrat dhe udhëzimet e dhëna në ditarin e objektit, në zbatim të kontratës së punimeve dhe gjatë kolaudimit” dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Sipërmarrësi duhet t'i njoftojë me shkrim mbikëqyrësit të punimeve përfundimin e punimeve”.

-Për tenderin “Sistemim asfaltim rruga Fang faza e dytë Rubik” nuk ka njoftim nga sipërmarrësi i punimeve [REDAKTUAR], për përfundimin e punimeve në datën 27.9.2011 as edhe nga mbikëqyrësi i punimeve [REDAKTUAR] dhe sipas shtesës së kontratës nr. 36/26-1, datë 01.8.2011 nga kryetari i Bashkisë [REDAKTUAR] shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve nga data 27.9.2011 deri në datën 31.10.2011 nuk është bërë në bazë të kërkesës së sipërmarrësit të punimeve [REDAKTUAR] dhe aprovimit të dhënë nga mbikëqyrësi i punimeve [REDAKTUAR] as edhe rasteve të përmendura në kontratën bazë nr. 5, datë 27.6.2011 neni 25, “Rastet e kompensuar”, shtyrja e punimeve ndodh kur:

- a-kur mbikëqyrësi i punimeve urdhëron shtyrjen ose nuk jep skicat, specifikimet teknike për kryerjen e punimeve.
- b- për zbulimin e punimeve të fshehta.
- c- vonesat në lirimimin e sheshit të ndërtimit.
- d- vonesat në lëshimin e certifikatës së marrjes në dorëzim.

Arsyeja për shtyrjen sipas kontratës shtesë është: “...për shkak të stazhit të nevojshëm që ka ura (betoni) për të arritur markën e duhur”.

Në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001, pika 15 “Sipërmarrësi duhet t'i njoftojë me shkrim mbikëqyrësit të punimeve përfundimin e punimeve” dhe UKM nr. 2, datë 13.5.2005 kreu I, pika, 7.2 “Propozimet për zgjatjen e afatit të punimeve i paraqiten investitorit, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve dhe nuk janë në kundërshtim me kushtet e kontratës”, 7.3 “Ndryshimet e miratuara nga investitori.....i dorëzohen zyrtarisht, sipërmarrësit”, kreu II, pika 10. “Mbikëqyrësi, me kërkesë të sipërmarrësit, vërteton në procesverbal datën e përfundimit të punimeve, sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e kushteve të kontratës”.

Përfundimisht kontratat shtesë janë lidhur për ato arsye të cilat ndalohen nga nenet e kontratave bazë të përmendura më sipër dhe në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” kreu III, pika 1/c .”

Shkeljet e konstatuara janë në kundërshtim me nenin 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, “Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, që i janë vënë në dispozicion, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij”.

-Nga autoriteti kontraktor nuk është hartuar regjistri i realizimit të prokurimeve publike nga muaji shtator deri në fund të vitit 2011 në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu I, pika 3/d “Brenda datës....., 20 janar, çdo institucion qendror apo çdo institucion tjetër....., i dërgon APP-së një raport të prokurimeve të realizuara, të kryera prej tyre....”.

2. [REDAKTUAR] titullari i Autoritetit Kontraktor:

Për shkeljet e konstatuara në prokurimet publike të kryera nga Bashkia Rubik për vitet 2010, 2011, si më poshtë:

-Për tenderin “Sistemim asfaltim rruga Fang faza e parë Rrubik”, është hartuar dhe firmosur nga Kryetari i Bashkisë [REDAKTUAR] dhe sipërmarrësi [REDAKTUAR] kontrata nr. 2, datë 16.5.2011 dhe sipas nenit 3, afati i kontratës është 60 ditë dhe me shkronja është (nëntëdhjetë) ditë në kundërshtim me afatet 60 ditore të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit seksioni

II. 3 për të cilat është konkurruar dhe formularit të publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar.

-Për prokurimin “Sistemim asfaltim rruga Fang faza e dytë Rubik” dhe “Rrethimi i fushës së futbollit Rubik”, autoriteti kontraktor ka filluar procedurën e prokurimit pa pasur në dispozicion fondet publike në kundërshtim me ligjin nr. 9463, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 12/1, “Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, që i janë vënë në dispozicion, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu I, pika 1.

-Nga autoriteti kontraktor bashkia Rubik nuk është mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të mjeteve të prokuruar me tenderin “Blerje makineri dhe pajisje për bashkinë Rubik” sipas kërkesave të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b: “Për t’u siguruar nëse cilësia.... e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet,.... Autoriteti kontraktor, mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës”, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 54, datë 15.7.2010 “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, rregullorja për menaxhimin e aktiveve, pika A “procedura për administrimin e vlerave monetare dhe materiale: IV veprimet që kryejnë sektorët e financës, “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, llogaritari duhet të kontrollojë në se fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës: a. Procesverbali i firmosur nga komisioni, b. Fatura e furnitorit të fotokopjuar, c. Fletë hyrje origjinale, d. Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit”.

3. Për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

███ drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban me cilësinë e kryetarit të KVO.
███ i drejtor i ndihmës ekonomike, anëtar i KVO.
███ specialist, anëtar i KVO.

Për shkeljet e konstatuara në vlerësimin e prokurimeve publike të kryera nga Bashkia Rubik për vitet 2010, 2011, si më poshtë:

-Në prokurimin me objekt “Sistemim asfaltim rruga Fang faza e parë Rrubik”, nga verifikimi i procesverbalit të vlerësimit të ofertave dhe ato në formatin elektronik del se nga KVO nuk janë marrë parasysh zbatimi i kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit si “Sigurimet shoqërore me listprezencën për stafin drejtues për vitin 2009 dhe 2010”.

Për operatorin █████:

Tre drejtuesit teknikë në listpagesat e periudhës janar-tetor 2010 janë të siguruar specialiste me pagë bruto 42,858 lekë, █████ figuron i siguruar vetëm një muaj me pagën bruto 18,000 lekë, specialistë në zbatim me 20,000 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2/d: “nuk i ka përbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar....”, me VKM nr. 285, datë 4.5.2007, “Përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore” dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007, pika 4/v, ku sipas veprimtarisë ekonomike dhe kategorisë paga bruto duhej të ishte për drejtuesit teknikë 150,000 lekë, specialistët në zbatim 33,000 lekë dhe administratorin 250,000 lekë.

Për operatorin █████:

Për periudhën janar-dhjetor 2010 specialistët në zbatim janë të siguruar me pagë bruto 25 300 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2/d: “nuk i ka përbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar....”, me VKM nr. 285, datë 4.5.2007, “Përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore” dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007,

pika 4/v, ku sipas veprimtarisë ekonomike dhe kategorisë paga bruto duhej të ishte për specialistët në zbatim 30,000 lekë.

Për operatorin [REDAKTUAR]:

Tre drejtuesit teknikë në listëpagesat e periudhës janar-dhjetor 2010 janë të siguruar drejtuesit teknikë me pagën bruto 35,000 lekë, 80,000 lekë dhe 90,000 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2/d: “nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.....”, me VKM nr. 285, datë 4.5.2007, “Përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore” dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007, pika 4/v, ku sipas veprimtarisë ekonomike dhe kategorisë paga bruto duhej të ishte për drejtuesit teknikë 150,000 lekë.

Nga konstatimet e mësipërme KVO duhej të kishte skualifikuar operatorët pjesëmarrës.

-Në prokurimin me objekt “Sistemim asfaltim rruga Fang faza e dytë Rrubik”, nga verifikimi i procesverbalit të vlerësimit të ofertave dhe ato në formatin elektronik del se nga KVO nuk janë marrë parasysh zbatimi i kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit si “Sigurimet shoqërore me listëprezencën për stafin drejtues për vitin 2009 dhe 2010”.

Për operatorin [REDAKTUAR]:

Në listpagesat e periudhës janar-mars 2011 një drejtues teknikë është i siguruar me pagën bruto 4,284 lekë dhe 30,000 lekë dhe një drejtues teknik nuk figuron në listpagesa. Në periudhën janar-tetor 2010 tre drejtuesit teknikë janë të siguruar specialiste me pagë bruto 42,858 lekë, [REDAKTUAR] figuron i siguruar vetëm një muaj me pagën bruto 18,000 lekë, specialistë në zbatim me 20,000 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2/d: “nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.....”, me VKM nr. 285, datë 4.5.2007, “Përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore” dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007, pika 4/v, ku sipas veprimtarisë ekonomike dhe kategorisë paga bruto duhej të ishte për drejtuesit teknikë 150,000 lekë, specialistët në zbatim 33,000 lekë dhe administratorin 250,000 lekë.

Për operatorin “E” sh.p.k.:

Për periudhën janar-dhjetor 2010 specialistët në zbatim janë të siguruar me pagë bruto 25 300 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2/d: “nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.....”, me VKM nr. 285, datë 4.5.2007, “Përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore” dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007, pika 4/v, ku sipas veprimtarisë ekonomike dhe kategorisë paga bruto duhej të ishte për specialistët në zbatim 30,000 lekë.

Për operatorin [REDAKTUAR]:

Tre drejtuesit teknikë në listpagesat e periudhës janar-mars 2011, janar-dhjetor 2010 janë të siguruar drejtuesit teknikë me pagën bruto 35,000 lekë, 80,000 lekë dhe 90,000 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2/d: “nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.....”, me VKM nr. 285, datë 4.5.2007, “Përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore” dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007, pika 4/v, ku sipas veprimtarisë ekonomike dhe kategorisë paga bruto duhej të ishte për drejtuesit teknikë 150,000 lekë.

Nga konstatimet e mësipërme KVO duhej të kishte skualifikuar operatorët pjesëmarrës.

-Në prokurimin me objekt “Shërbimi i pastrimit në qytetin Rubik”, nuk ka procesverbal të vlerësimit të ofertave nga KVO në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 12/2, “Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe

dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VI, pika 1/c “Gjatë veprimtarisë (përgatitja e kërkesës dhe vlerësimi i propozimeve) duhet të mbahet procesverbal i prokurimit, i cili duhet të nënshkruhet nga të gjithë zyrtarët e përfshirë në proces”.

-Nga verifikimi i vlerësimit të ofertave në formatin elektronik del se nga KVO nuk janë marrë parasysh zbatimi i kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit si “Një punësim mesatar prej 15 punëtorësh për vitin 2010 dhe jo më pak se 8 punëtorë për vitet 2008 dhe 2009, shoqëruar me listpagesat për vitin 2010” për sigurimet shoqërore si më poshtë:

Firmat ofertuese [REDACTED]:

Në listpagesat e periudhës janar-mars 2010 administratori [REDACTED] është i siguruar me pagën bruto 27,580 lekë dhe drejtuesi teknik [REDACTED] nuk figuron në listpagesa, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2/d: “nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.....”, me VKM nr. 285, datë 4.5.2007, “Përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore” dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007, pika 4/i, ku sipas veprimtarisë ekonomike dhe kategorisë paga bruto duhej të ishte për drejtuesit teknikë 40,000 lekë, dhe administratorin 80,000 lekë.

Firmat ofertuese [REDACTED]:

Në listpagesat e periudhës janar-mars 2010 administratori [REDACTED] është i siguruar me pagën bruto 35,000 lekë dhe drejtuesi teknik [REDACTED] është i siguruar me pagën bruto 25,000 lekë, drejtuesi ekzekutiv [REDACTED] është i siguruar me pagën bruto 20,000 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2/d: “nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.....”, me VKM nr. 285, datë 4.5.2007, “Përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore” dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007, pika 4/i, ku sipas veprimtarisë ekonomike dhe kategorisë paga bruto duhej të ishte për drejtuesit teknikë 40,000 lekë, dhe administratorin 80,000 lekë.

Firmat ofertuese [REDACTED]:

Në listpagesat e periudhës janar-mars 2010 drejtuesit teknik [REDACTED] dhe [REDACTED] nuk janë të siguruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2/d: “nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.....”, me VKM nr. 285, datë 4.5.2007, “Përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore” dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007, pika 4/i, ku sipas veprimtarisë ekonomike dhe kategorisë paga bruto duhej të ishte për drejtuesit teknikë 40,000 lekë.

Për sa më lart firmat ofertuese [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] për vlerësimin e listpagesave, pagës bruto dhe sigurimet shoqërore duhej të skualifikoheshin.

-Në prokurimin me objekt “Blerje makineri dhe pajisje për bashkinë Rubik”, nga kontrolli elektronik operatori [REDACTED] për kërkesën e DST “Furnizime të ngjashme në një vlerë prej 1,500,000 lekë të realizuara gjatë tre vjetëve të fundit të aktivitetit të operatorit” tek dosja “dorëzimi i ofertave” ka hedhur në formatin e elektronik një kontratë shitblerje me vlerë 600,000 lekë e cila nuk i përgjigjet kërkesës së mësipërme të DST dhe për këtë arsye KVO duhej të skualifikonte operatorin e mësipërm.

-Në prokurimin me objekt “Rrethimi i fushës së futbollit Rubik”, në proces verbalin e vlerësimit të ofertave nga KVO nuk cilësohet oferta e sjellë nga ofertuesit dhe arsyet përse janë skualifikuar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 12/2, “Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të

lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VI, pika 1/c “Gjatë veprimtarisë (përgatitja e kërkesës dhe vlerësimi i propozimeve) duhet të mbahet procesverbal i prokurimit, i cili duhet të nënshkruhet nga të gjithë zyrtarët e përfshirë në proces”.

-Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, me ndryshimet, neni 12, pika 2 dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 Kreu i V, pika 4, germa i.

D. MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.6.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim”, neni 25, pika 3, germa “b”,

- Për zj. █████ me detyrë drejtore e Drejtorisë së Financës, për mos ushtrim të kontrollit në drejtim të hartimit të listëpagesave dhe zbatimit të ligjshmërisë në dhënien e pagave, ku si rrjedhojë, nga auditimi u konstatuan një sërë shkeljesh me efekte financiare.

2. Mbështetur në nenin 37 e 140 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe kontratës të punës, kërkojmë që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

“Zgjidhja e kontratës së punës”

- Për znj. █████ me detyrë inspektore e financës, specialiste e pagave.

Për veprim në kundërshtim me germën “ç” të nenit 32 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ku pa miratim të Këshillit Bashkiak:

- Për vitin 2011 janë paguar katër punonjës mësimorë të konviktit me një ndikim në fondin e pagave prej 2,244 mijë lekë.

- Janë ndryshuar disa herë pagat e punonjësve të çerdhes, të punëtorëve të konviktit dhe të punëtorëve të mirëmbajtjes.

- Janë paguar 2 punonjës të përforcuesit televiziv me pagën 8,000 lekë në muaj, me një fond page 192 mijë lekë në vit.

- Për punëtorët e konviktit dhe të çerdhes së fëmijëve mbi pagën e miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe të vendosur në mbështetje të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 717, datë 23.6.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, lidhja nr. II, janë dhënë shtesa për vjetërsi në punë, ku si rrjedhojë për vitin 2010 dhe vitin 2011 punonjësit kanë përfituar pagë tepër 757,485 lekë.

- Mbi pagën e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 2, datë 4.02.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Bashkisë Rubik, si dhe pagat e tyre” për çdo muaj është paguar z. █████ me detyrë roje i konviktit për 33 ditë pune, kur ndërkohë i janë paguar edhe 40 orë shtesë për çdo muaj. Si rrjedhojë paga e përfituar tepër shumën 145,772 lekë gjithsej.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Bexhet Zeqiri dhe Vasillaq Peci. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT